

BIBLIOTEKA
SHTETIT

JH-7
P50

KOLEC PEPA

Tregime
humoristike



**PUNE
SHKRONJASH...**



814-7
P50

KOLEC PEPA

PUNË SHKRONJASH...

tregime humoristike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

AKSIONI I SË DIELËS

Gëzimi kësaj radhe ishte i dyfishtë. U gëzuan fëmijët për pallatin e ri, që sapo përfundoi dhe së bashku me ta u gëzuan edhe ne të rrugicës. Meqë rrugica po zgjerohet dhe po ndërtohetshin pallate anash, është e natyrshme që prapashtesa «ica» do t'i hiqej dhe tani e tutje do të quhej thjesht rrugë, si gjithë rrugët e tjera të qytetit tonë.

Dritat e pallatit të porsandërtuar filluan të ndize-shin, shenjë kjo që tregonte se mysafirët e rinj ishin rregulluar nëpër hyrjet e tyre. U gëzuan edhe kalamajtë. Kjo erdhi për shkak se shpresonin të plotësonin numrin e lojtarëve që do të përbënin formacionin e skuadrës së futbollit të lagjes. Ajo që është më e rëndësishmja, u realizua. U gjet portieri dhe një gjysmëmbrojtës që mungonte. Për dy të tjerët të vijës së sulmit kishin shpresa te bano-rët që ende nuk kishin ardhur.

— Si do t'ia vëmë emrin skuadrës? — pyeti dikush.

— «Rrufeja», — tha Artani, që sapo u zgjodh kapiten i saj.

— «Çeliku», — propozoi një tjetër.

— Unë jam për të dytën, — tha një i tretë.

— Urraa! — u dëgjuan si në kor zërat e fëmijëve.

— Dakord, dakord!

— Dëgjoni këtu, — tha Artani, duke i përgëzuar për nderin që iu bë.

— Ju premtoj që, sa të përfundojë pesëkatëshi përkarshi këtij, unë do të kryej edhe detyrën e tranierit të skuadrës. Dakord?

— Jemi dakord.

— Nesër do të vini me kanotiere të bardha, se do të shkruajmë numrat te piktofi. Ka kush pyetje?

— Me leje?

— Urdhëro dhe fol!

Ai që e donte fjalën ishte një mbrojtës i ardhshëm. More shokë, ju i dini më mirë shtigjet, sepse unë jam mysafir në rrugicën tuaj. Po s'di ku do t'i bëjmë stërvitjet, pa le ndeshjet. . .

— Kemi fushën e xha Dylit — tha dikush me gjysmë zëri.

— Cilën? Fushën e xha Dylit? Aty filluan ndërtime, more vëlla.

— Të gjejmë ndonjë tjetër! Në fund të rrugicës është një shesh ku janë hapur disa kanale. T'i mbyllim dhe të sheshojmë vendin — tha Mali i vogël ose më saktë Mal rezerva.

— Tamam, besa! — u hodh një tjetër. — Aty kanë hapur themelet për një pesëkatësh. M'u qërrofshin sytë po nuk qe kështu! Bile ato i kanë hapur me kontribut vullnetar shokët e babait. Mendoni për ndonjë vend tjetër!

— Po karshi atij vendi a mund të lozim?

— Ky është mendim i mirë.

— Të vemi ta shikojmë, pastaj e vendosim, — tha kapiteni i skuadrës.

Të gjithë së bashku u nisën për në vendin e dëshiruar. Një grumbull parcelash të pasistemuara dhe të mbuluara me bar që mbulonin sheshin të pengonin pamjen.

— Hajde, futemi brenda! — propozoi njëri. — Të shohim më mirë sheshin.

Në mes të vendit një xhaxho po gërhiste për shtatë palë qeife duke plotësuar gjumin e natës, humbur në ndonjë ziafet.

— Po ju, more, ç'kërkoni? Si keni hyrë këtu? — thirri ai sa i pa.

— Me këmbë, xhaxho...

— Pse nuk ecni rrugëve, por kështu, shkapërdedhur nëpër parcela?

— Mendojmë ta sheshojmë, xhaxho, se këtu do të ndërtojmë një fushë sporti.

— Këtu?! — tha xhaxhoja, duke i dhënë gërmës së fundit theksin habitor. — Ju lanë mendtë... apo... si është puna? A e dini se kjo është lulishte? A e dini se unë paguhem për mirëmbajtjen e saj?

— Ku janë lulet, xhaxho?

— Epo lulet nuk çelin të gjitha në një stinë, — ia ktheu xhaxhoja. — Ka nga ato që lulëzojnë në behar, porse ka edhe të tjera që çelin në dimër.

— Këto siç duket qenkan nga ato të dimrit, — tha me ironi Mali i vogël. Kjo ngjalli të qeshura. Kështu që dashje padashje edhe xhaxhoja vuri buzën në gaz.

— E gjeta, shokë, mbetet vetëm ta aprovojmë.

— Fol, se nuk na durohet.

— Në taracën e pallatit ku kemi hyrë tani. Vendi është i rrethuar anash me mure dhe është mjaft i hapur e mund të lozin pa frikë.

— Ky është një propozim me vend.

— A do të na lejojnë?

— Mjaft që të ngjitemi njëherë, se pastaj mbyllim hyrjen nga brenda.

— Propozim i bukur!

— Kur t'u bien topat poshtë, do t'jua sjell unë, —
tha Mal rezerva.

Dita e inaugurimit erdhi. Kjo ngjau në një ditë pa re
në qiell, pasdite, kur banorët e pallatit po bënëin pushi-
min e drekës.

— More, dëgjoni gjë apo jo?!

— Tërmet, sigurisht — i tha Zeka së shoqes i tre-
mbur, sapo i doli gjumi.

— Duket se qe i fortë, ngaqë na zgjoi.

— Sigurisht nëntë ballësh, — tha Zeka.

— More, ç'bëhet kështu? — thanë ata të katit të pe-
stë. — Po të ishte tërmet do të fillonin dridhjet nga po-
shtë!

— Epo ka edhe lëkundje sizmike të tilla, që vijnë në
drejtim horizontal, — tha njëri që sapo doli në ballkon.

— Uluni poshtë, se në ju kapsha do t'ju shkul ve-
shët! — thërriste dikush i nevrikosur nga kati i pestë.

— Duam të lozim — përgjigjej një zë fëmije.

— Uluni poshtë, se na prishët qetësinë! Nuk është
vend për të luajtur aty.

— Na caktoni vendin ku të luajmë, pastaj do të ule-
mi. . .

— Hidhe topin Bato! Forcaaaa!!! Gjuaje! Gool!!!. . .

— U pa puna, — tha një i moshuar, — sot u bëmë
gazi i botës. Unë mendoj që ditën e diel ta shpallim ditë
aksioni.

Dhe me të vërtetë, një afishe e vendosur te hyrja e
pallatit të ri shkruante: «Ditën e diel, më datën aq e kaq
banorët e pallatit numër 7 kanë aksion për ndërtimin e
një sheshi sportiv për fëmijët e rrugës sonë».

DY KONTRASTËT

Qytetarët kishin zënë vend para derës dhe prisnin.

— Të hyjë njëshi! — tha një vajzë flokëgështenjë, që sapo çeli derën.

— Unë, — u përgjigj një plakë, duke çarë grumbullin.

— Tani e ka dyshi, pastaj treshi, katra dhe pesa. A është kështu, more burra? Hë de, flisni! Apo ju është kyçur goja? — u dëgjua një zë burri.

Ky që fliste me zë të lartë ishte një plak rreth të shtatëdhjetave.

— Ju lutem të më lini radhën! — tha njëri, që sapo erdhi. — Mendoni se keni para jush një qytetar shumë të sëmurë.

— Për çfarë ankohesh? — e pyeti plaku shtatëdhjetëvjeçar me kureshtje.

— Akoma nuk e di diagnozën.

— Të hyjë, të hyjë! — u dëgjuan zëra.

— Meqë qenka «urgjencë», ia falim radhën, — tha një grua.

Plaku vrenjti vetullat dhe i mbërtheu qytetarit që i zuri radhën një vështrim qortues, derisa kanata e derës që sapo u mbyll, i zuri pamjen.

— Jam shumë i sëmurë shoku doktor. Nuk mund të qëndroj në këmbë. Edhe ngritja e peshave më bën dëm. Pagjumësinë e kam vdekje.

— Çfarë profesioni keni?

— Llogaritar në Ndërmarrjen e riparim-shërbimit.

— Atëherë ç'hyn këtu pagjumësia, ngritja e peshave?

— Dua rekomandim, rekomandim! Ai është ilaçi kryesor. Një rekomandim për në komisionin mjekoligjor dhe asgjë tjetër. Duke ju falënderuar që më përpara, rri në pritje të plotësimit të kërkesës sime.

Mjeku, të cilit gjatë karrierës së tij si mjek nuk i kishte ndodhur të takonte një të sëmurë si ky, i tha me gjakftohtësi:

— Qetësohu! Ku e ke hallin? Si qëndron puna jote?

Pacienti zbardhi dhëmbët. Një buzëqeshje ironike ia përshkoi buzët.

— Çështje zbori, shoku doktor. Mendoni se stërvitja zhvillohet në kushte të vështira atmosferike.

— Ashtu?! Dhe ju doni rekomandim për t'i shpëtuar? Qenkeni simulant.

— Dil, more shok! Mirë se të lamë radhën, por edhe po na vonon!

Ky që foli ishte plaku shtatëdhjetëvjeçar, që kishte nxjerrë kokën te dera.

— Mund të shkoni. Vizita juaj mbaroi. Të hyjë tjetri. Regjistroje tjetrin! — tha mjeku.

Xhaxhoja, duke u mbushur me frymë, hyri brenda. Shikimi i tij qortues u bë shkak që të ndërpritej biseda. Pacienti që hyri jashtë radhës uli kokën dhe, duke murmuritur nëpër dhëmbë, doli jashtë.

Infermierja filloi rregjistrimin.

— Emrin!

— Mirash Shkëmbi.

— Sa vjeç?

— Ky është dimri i shtatëdhjetë që po kaloj.

— Për çfarë ankohesh? — pyeti mjeku.

— Që ta dini mirë punën time, shoku doktor, dhe ti shoqja infermiere, unë banoj në malësi, buzë kufirit. Jam komshi me të keqin. Mirëpo ka disa kohë që më ka zënë reumatizmi krahun e djathtë. Unë bëj pjesë në çetën vullnetare të fshatit tim. . . Që thoni ju, po lindi nevoja që të luaj këtë (përkuli gishtin tregues duke e lëvizur disa herë) si do t'i bëhet hallit? Për atë rreze dielli që na ngroh të gjithëve ne nuk e kemi zakon të koritemi. . .

— Xhaxho, reumatizmi ka lidhje me moshën — tha mjeku shtruar.

Plaku, sikur ta pickonte diçka, me fytyrë të skuqur, u hodh:

— Të një moshe, more burrë i dheut, janë të dy krahet! Si qenka plakur njëri para tjetrit? Mblidhe, more, mendjen dhe përgjigju ashtu siç e lyp zanati!

Mjeku qeshi, ndërsa xhaxhoja u ngrys. Pastaj, duke u munduar që të tregohej i çiltër, vazhdoi:

— Nuk ta merr mendja sa më mundon kur është vrerët. Pastaj nuk duhet harruar se ujku mjegull kërkon. Në qoftë se është e mundur bën çmos e ma kalo reumatizmin diku tjetër, vetëm krahun e pushkës ta kem të lirshëm.

Infermierja shikoi mjekun dhe shkëmbyen një buzëqeshje.

— Hë de, flisni! Nuk ka gjë për të qeshur këtu!

— Po të jap disa hape — tha mjeku.

— Por mos harro se edhe pleqëria bën të sajën — shtoi infermierja.

— Nuk kam nevojë për llafe, shoqe — tha plaku dhe, duke ia rrëmbyer recetën nga duart, doli.

